

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“TOKËDETI” sh.p.k.**

Sot, me date 23 Prill 2024, ne te neneshkruarit:

- Z. Jean-Guillaume, Paul Dubuis shtetas Francez i datelindjes 28.11.1975 mbajtes i pashaportes me nr. 22HD07251 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

- Z. Francois, Roland, Albert Cadeau shtetas Francez i datelindjes 21.10.1970 mbajtes i pashaportes me nr. 22AD34762 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

- Znj. Anne-Aurellie, Denise Le Mat shtetase Franceze e datelindjes 25.10.1975 mbajtese e pashaportes me nr. 23KH10174 madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” (i ndryshuar) dhe vendimet perkatese te shoqerive, kemi vendosur te themelojme nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar “TOKËDETI” sh.p.k (me poshte referuar si “Shoqeria”), duke neneshkruar kete Akt Themelimi, Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te regullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqerise eshte “TOKËDETI” sh.p.k.

Neni 2

Selia e Shoqerise ndodhet ne Adresen: “Rr. Tom Plezha, Pallati Milo, Seksioni 1, Shk. 2, K. 6, Ap. 34, Tirane”. Shoqeria ka te drejte te hape dege dhe filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithë vendin, brenda ose jashte territorit te vendit, gjate aktivitetit te saj.

Neni 3

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si vijon:

Aktivitet ne fushen e pasurive te patundshme, vleresimin e pasurive te patundshme, te angazhohet ne shitjen me shumice dhe pakice te çdo lloj pasurie dhe te hap dyqane, dege apo zyra po te jete e nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise. Manaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Investime ne fushen e ndertimit dhe tregtimit brenda dhe jashte vendit te pasurive te pa luajtshme. Administrimin e bashkepronesise ne ndertesa. Per dhenien me qera, nen qera te ambjenteve te ndryshme. si dhe çdo veprimtari tjetere e cila i sherben permbushjes se qellimit te shoqerise dhe qe nuk ndalohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 5

Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 1 000 euro, i barazvlefshem me 100 000 (njqind mije) leke dhe i ndare ne 3 pjese (kuota) me vlere nomiale 100 000 (njqind mije) leke.

Kapitali zoterohet nga ortakët e shoqerise si me poshte:



AA le hoh

- Z. Jean-Guillaume, Paul Dubuis, i cili zoteron 1 (nje) kuote te Shoqerise ose 50 000 (pesedhjete mije) leke qe perfaqesojne 50 % te kapitalit te Shoqerise.
- Z. Francois, Roland, Albert Cadeau i cili zoteron 1 (nje) kuote te Shoqerise ose 25 000 (njezet e pese mije) leke qe perfaqesojne 25 % te kapitalit te Shoqerise.
- Znj. Anne-Aurellie, Denise Le Mat e cila zoteron 1 (nje) kuote te Shoqerise ose 25 000 (njezet e pese mije) leke qe perfaqesojne 25 % te kapitalit te Shoqerise.

Ortaket e Shoqerise mund te vendosin te rrisin kapitalin e Shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise. Detyrimet e ortakëve te shoqerise kundrejt Shoqerise do te mbulohet vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tyre.

Neni 6

Shoqeria vepron nen rregjimin e prones private dhe merr persiper vetes te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore.

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhtme:

- Asambleja e Pergjithshme;
- Administratori;

Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme si dhe te administratorit te Shoqerise jane te parashkruara ne Statutin e Shoqerise.

Neni 7

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet, e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

Neni 8

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektojne rregullat ne fuqi te punesimi dhe te punesuarit jane te detyruar qe ta respektojne Statutin e kesaj Shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe shkaktojne kesaj Shoqerie me veprimet dhe mosveprimet e tyre.

Neni 9

Ne rast se Shoqeria do te mbyll aktivitetin e saj per cdo lloj arsye, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakëve te Shoqerise, percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c' regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Neni 10

Kontrolli mbi veprimtarine e Shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e Shoqerise i besohet nje eksperti kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve qe ben ligji per ekspertet dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Pergjithshme cakton edhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 11

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te secilit vit. Perjashtim, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor. Administratori merr masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin.



Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakeve te Shoqerise.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.
Per sa eshte shprehur ne kete Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" (i ndryshuar).

ORTAKET
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"TOKËDETI" sh.p.k.

François ADEAU

Emer Mbiemer Nenshkrimi

Anne-Aurèle LE DAT

Emer Mbiemer Nenshkrimi

Jean-Guillaume DOBUI

Emer Mbiemer Nenshkrimi